



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) duke vepruar në bazë të lëndës së formuar me vet iniciativë, në seancën e 82-të, të mbajtur më datë 14.02.2023 morri,

VENDIM

Procedura e KSHPK-së sipas lëndës me numër 08-4824/1, datë 12.11.2021, e krijuar me iniciativë të saj, për shkelje të dispozitave të nenit 82 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nga _____, ish-anëtar i _____ .NDËRPRITET

Konstatohet se pas kundërvajtjes së lëshuar me urdhërpagesë me numër 08-730/6, datë 02.06.2022, personi i përmendur ka vepruar, pra është paguar gjysma e gjobës së përcaktuar në të.

KSHPK -ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në rastin konkret.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda e regjistruar me numër 08-4824/1 datë 12.11.2021 është formuar me vetiniciativë.

KSHPK-ja, nga kontrolli në Gazetën Zyrtare të RMV-së numër 190/2021, ka konstatuar se _____ me Vendimin nr. 14-8473/1 datë 30.07.2021, anëtar i Këshillit _____ dhe

në afatin e paraparë me ligj, pas ndërprerjes së funksionit nuk ka dorëzuarë fletë anketuese në KSHPK.

Për sa më sipër, KSHPK-ja i ka lëshuar personit të përmendur një urdhërpagesë kundërvajtëse nr. 08-730/6, datë 02.06.2022, për shkelje të kryer nga neni 82 paragrafi 3 i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, dënueshëm sipas nenit 109 të të njëjtit ligj.

Nga ana e personit të caktuar në afatin e përcaktuar ligjor është vepruar sipas urdhërpagesës kundërvajtëse, përkatësisht është paguar gjysma e gjobës së përcaktuar në të.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti:A.Ç.

Miratoi: Mr. Vladimir Georgiev anëtar në KSHPK

**KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
NËNKRYETARË,
Katica Nikolovska**